



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

RREGULLA PËR SKEMËN MBËSHTETËSE

(Për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet
e Ripërtritshme të Energjisë)

Prishtinë, xx nëntor 2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë në përputhje me Nenin 14 paragrafin 2 nënparagrafin 2.16 dhe Nenin 25 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligji Nr. 03/L-185, Nenit 13 të Ligjit për Energjinë nr. 03/L-184, Udhëzimin Administrativ 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 02/2013 për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE, në mbledhjen e mbajtur më datë **xx nëntor 2014** miratoi:

Rregullën për Skemën Mbështetëse

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Rregulla për Skemën Mbështetëse ka për qëllim përkrahjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, në mënyrë që të arrihen Caqet e përcaktuara të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Rregulla përcakton kriteret dhe procedurën për aplikim dhe pranim në Skemën Mbështetëse me qëllim përkrahjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.
2. Procedura e aplikimit për tu pranuar në Skemën Mbështetëse do të zbatohet në përputhje me kriteret objektive, transparente dhe jodiskriminuese, e cila përkrah krijimin e një tregu konkurrues të energjisë duke nxitur investime dhe duke garantuar sigurinë dhe stabilitetin e sektorit të energjisë në Kosovë.
3. Kjo Rregull nuk përfshin Njësitë gjeneruese, të cilat janë zhvilluar me procedura konkurruese, duke përfshirë pa kufizim procedurat e tenderimit për kapacitete të reja gjeneruese nga BRE-të, dhe për këtë nuk janë të kualifikueshme për Skemën Mbështetëse.

Neni 3

Përkufizimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregull, kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **“ZRRE”** - Zyra e Rregullatorit për Energji;
 - 1.2. **“Direktiva 2009/28/EC”** - Direktiva 2009/28/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 prill 2009 për Mbështetjen e shfrytëzimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme dhe ndryshimin si dhe rrjedhimisht shfuqizimin e Direktivave 2001/77/EC dhe 2003/30/EC;
 - 1.3. **“OST”** – Operatori i Sistemit të Transmisionit;
 - 1.4. **“OT”** - Operatori i Tregut;
 - 1.5. **OSSH** - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;

- 1.6. **“Njësi gjeneruese”** - kombinimi i gjeneratorëve, turbinave dhe pajisjeve të tjera të lidhura dhe të instaluar së bashku në një lokacion të vetëm për prodhimin e energjisë elektrike;
 - 1.7. **“Caqet”** - Caqet për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë sipas Udhëzimit administrativ nr. 01/13 të nxjerr nga Ministria;
 - 1.8. **“Burime të Ripërtërishme të Energjisë(BRE)”** – burime të ripërtërishme jo-fosile të energjisë, siç janë: energjia nga era, energjia diellore, energjia e ujit, energjia nga ujërat gjeotermale, energjia valore, bio-energjia, biomasa dhe bio-gazet; dhe
 - 1.9. **“Furnizues Publik”** - shoqëri e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të kryer veprimtarinë e furnizuesit publik me energji elektrike.
2. Shprehjet e përdorura në këtë rregull, kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Energjinë.

KREU II
APLIKIMI DHE KUSHTET PER PRANIM NË SKEMËN MBËSHTETËSE
Neni 4

Aplikimi për pranim në Skemën Mbështetëse

1. Operatori i njësisë gjeneruese duhet të aplikon për pranim në skemën mbështetëse me rastin e dorëzimit të aplikacionit të kompletuar për marrjen e Njoftimit mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.
2. Me Njoftimin mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar, brenda vendimit përkatës ZRRE, do të përcaktoj nëse caqet janë të disponueshme për tu kualifikuar aplikuesi për pranim në mënyrë automatike në skemën mbështetëse.
3. Njoftimit mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar i lëshuar nga ZRRE, dhe që përcakton pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse, në mënyrë automatike garanton Tarifen Nxitëse.
4. Në rast se aplikuesi, aplikon direkt për marrjen e autorizim final dhe parashtron kërkesën për pranim në skemën mbështetëse, ZRRE brenda vendimit përkatës do të përcaktoj nëse caqet janë të disponueshme, dhe aplikuesi kualifikohet për tu pranuar në mënyrë automatike në skemën mbështetëse.
5. Autorizimi final i lëshuar nga ZRRE dhe që përcakton pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse, në mënyrë automatike u garanton Tarifën Nxitëse.
6. Në momentin kur ZRRE ka lëshuar Njoftime mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar dhe Autorizimin final me të cilat janë përmbushur caqet e disponueshme, do të lajmëroj të gjithë aplikuesit tjerë, për përmbushjen e caqeve si dhe pamundësinë për të garantuar Tarifën Nxitëse sipas kësaj rregulle.
7. ZRRE do të konsideroj caqet e përmbushura, atëherë kur janë lëshuar Njoftimet mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar dhe Autorizimet Finale në kapacitetin e instaluar sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve deri në vitin 2020. Pavarësisht caqeve vjetore

kapacitetet e reja mund të lëshohen në operim për të gjitha caqet që janë përcaktuar me Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve deri në vitin 2020.

8. Në rastet kur aplikuesi vazhdon me procedurat për marrjen e Njoftimit mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar dhe Autorizimit final pa aplikuar në skemën mbështetëse, ZRRE brenda vendimit të saj do të specifikoj se aplikuesi nuk ka të drejt të mëtutjeshme për hyrje në skemën mbështetëse.
9. Nga momenti i plotësimit të caqeve të disponueshme me lëshimin e Njoftimeve mbi Vendimet për Autorizimin Preliminar dhe Autorizimet finale sipas kërkesave të aplikuesëve për hyrje në skemën mbështetëse, ZRRE do të specifikoj në vendimet përkatëse se, procesi për praninë në skemën mbështetëse do të ndalohet derisa të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 për BRE-të. ZRRE do të konsideroj këto aplikacione si aplikacione në “pritje”, për praninë në skemën mbështetëse.
10. Aplikuesit të cilit i është lëshuar Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar apo Autorizimi final me vërejtje nga ZRRE, sipas paragrafit 9 të kësaj rregulle, afatet e përcaktuara me Rregullën për procedurën e autorizimit, do të fillojnë të rrjedhin, jo nga data e lëshimit të vendimit përkatës, por nga data e njoftimit me shkrim nga ZRRE për përfshirje në skemën mbështetëse.
11. Nga momenti i lirim të caqeve të disponueshme aplikuesi do të njoftohet me shkrim nga ZRRE. Në rast se aplikuesi ka Njoftim mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar për kapacitet më të lart se caqet e liruara, aplikuesi do të ketë të drejt të kërkojë që Njoftim mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar të ndahet/modifikohet në atë mënyrë që i garantohet e drejta për caqet e liruara, ndërsa kapaciteti i mbetur mund të vazhdon të jetë “në pritje”, sipas kërkesës së aplikuesit.
12. Nga momenti i lirim të caqeve të disponueshme aplikuesi do të njoftohet me shkrim nga ZRRE. Në rast se aplikuesi ka Autorizim final për kapacitet më të lart se caqet e liruara, aplikuesi do të pres deri të lirohen caqet e disponueshme apo të kërkojë modifikimin e autorizimit final. Pjesa e kapacitetit të mbetur nuk do të vazhdon të jetë “në pritje” sikurse është përcaktuar për Njoftimin mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar të përcaktuar në paragrafin 11 të këtij neni.

Neni 5

Kufizimi i kapacitetit për praninë në skemën mbështetëse

1. Në skemën mbështetëse do të pranohen vetëm aplikacionet që aplikojnë për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të, sipas Rregullës për procedurën e autorizimit.
2. Kapaciteti i planifikuar në MW i aplikacioneve që do të pranohet në skemën mbështetëse, për prodhim të energjisë elektrike nga Energjia fotovoltaike do të jetë deri në dhe përfshirë 3 MW (≤ 3 MW).
3. Kapaciteti i planifikuar në MW i aplikacioneve që do të pranohet në skemën mbështetëse, për prodhim të energjisë elektrike nga Biomasa solide do të jetë deri në dhe përfshirë 4 MW (≤ 4 MW).

4. Kapaciteti i planifikuar në MW i aplikacioneve që do të pranohet në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Era do të jetë deri në dhe përfshirë 35 MW (≤ 35 MW).
5. Kapaciteti i planifikuar në MW për hidrocentrale nuk është i kufizuar përderisa, një njësi gjeneruese(turbinë) që do të pranohet në skemën mbështetëse për prodhim të energjisë elektrike do të jetë deri në dhe përfshirë 10 MW (≤ 10 MW).
6. Aplikacionet të cilat i tejkalojnë kapacitetet gjeneruese të përcaktuar sipas këtij neni nuk do të pranohen në skemën mbështetëse e as nuk u takon tarifa nxitëse sipas kësaj rregulle.

Neni 6

Kërkesa për pranim në skemën mbështetëse

1. Kërkesa me shkrim dorëzohet në ZRRE duke plotësuar Shtojcën 1 të kësaj rregulle.
2. Kërkesa për pranim në skeme mbështetëse duhet të dorëzohet me rastin e aplikimit për lëshimin e autorizimit sipas Rregullës mbi Procedurën e Autorizimit.
3. Te gjitha aplikacionet për marrjen e autorizimit që nuk e përmbajnë kërkesën për pranim në skemën mbështetëse, apo që vazhdojnë me aplikim për autorizim për ndërtim duke hequr dorë nga kërkesa për pranim në skemën mbështetëse, nuk do të pranohen në skemën mbështetëse në të ardhmen sipas kësaj rregulle.

Neni 7

Regjistri i skemës mbështetëse

1. ZRRE do të krijojë dhe azhurnon vazhdimisht regjistrin e skemës mbështetëse të energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
2. ZRRE për pranimin në skemën mbështetëse krijon regjistrin i cili do të përmbajë aplikacionet të pranuar në skemën mbështetëse dhe njësitë gjeneruese në pritje për pranim në skemën mbështetëse.
3. Aplikacionet që konsiderohen si aplikacione në pritje do të evidentohen në regjistrin e pritjes sipas datës së lëshimit të Njoftimit mbi Vendimin për Autorizim Preliminar apo lëshimit të Autorizimit final.
4. ZRRE gjatë krijimit të regjistrit dhe zbatimit të procedurave të aplikacioneve “në pritje” për pranim në skemën mbështetëse, i trajton në mënyrë të barabartë poseduesit e Njoftimeve mbi Vendimin për Autorizim Preliminar dhe Autorizimit final dhe vepron sipas renditjes kronologjike në regjistrin.
5. ZRRE, do të njoftojë aplikuesit të cilët janë në regjistrin e pritjes sipas rendit të aplikacioneve me rastin e lirim të caqeve të disponueshme.
6. Regjistri për skemën mbështetëse do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së dhe do të përditësohet në bazë të aplikacioneve të reja.

Neni 8
Tarifat nxitëse për skemën mbështetëse

- 1 ZRRE përcakton Tarifat nxitëse, të cilat janë të garantuara sipas nenit 4 paragrafi 3 dhe 5 të kësaj rregulle, dhe të aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese të pranuar në skemën mbështetëse.
- 2 Tarifat nxitëse të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, sipas vendimit përkatës do të përshtaten për inflacion për çdo vit, pas vitit të parë të operimit. Datat e sakta të mënyrës së aplikimit të inflacionit do të përcaktohen me marrëveshje të blerjes së energjisë (MBE). Norma e inflacionit do të përcaktohet sipas normës së ndryshimit, përgjatë 12 muajve paraprak, në nivelin e “Çmimeve të produktit të brendshëm industrial – mallrat kapitale NACE Rev2)” indeksi për 15 vendet e Eurozonës (ea15), të publikuara nga Eurostat.

Neni 9
Vlerësimi i kërkesës

- 1 ZRRE do të vlerëson përmbajtjen e kërkesës për pranim në skemën mbështetëse së bashku me aplikacionin për autorizim.
- 2 Çdo ndryshim apo modifikim që kërkohet nga ZRRE për pranim në skemën mbështetëse do të kërkohet gjatë vlerësimit të aplikacionit për autorizim, sipas rregullës për procedurën e autorizimit.
- 3 ZRRE e informon aplikantin për pranimin apo refuzimin e pranimit në skemën mbështetëse përmes vendimit për autorizim. Në rastin kur aplikacioni refuzohet, ZRRE jep shpjegim për arsyet që shpiejnë në këtë refuzim.

Neni 10
Përgjashtimi nga skema mbështetëse

- 1 Aplikuesit të cilat nuk kanë autorizime valide sipas Rregullës për procedurën e autorizimit do të përjashtohen nga skema mbështetëse në mënyrë automatike.
- 2 Një njësi gjeneruese e pranuar në skemën mbështetëse mund të tërhiqet nga Skema me anë të një kërkesë me shkrim të operatorit të saj drejtuar ZRRE-së.
- 3 ZRRE konfirmon tërheqjen e njësisë gjeneruese nga skema mbështetëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kërkesës dhe e fshinë njësinë gjeneruese nga Regjistri i njësive të pranuar në skemën mbështetëse.
- 4 Një njësi gjeneruese, e cila përjashtohet nga skema mbështetëse nuk lejohet të aplikojë për ripranim në Skemë në ndonjë datë të mëvonshme.

Neni 11
Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të njësive gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse

- 1 Operatori i njësive gjeneruese të pranuar në skemën mbështetëse do të shesë energjinë elektrike të prodhuar nga burimi (burimet) e ripërtëritshme të energjisë nga njësi gjeneruese tek Furnizuesi Publik i licencuar nga ZRRE, prej datës së fillimit të operimit siç është e përcaktuar në nenin 9 i Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 03/L-201.

2. Shitja e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik mbulohet nga Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike, e cila lidhet ne mes te gjeneratorit të BRE-ve dhe Furnizuesit Publik.
3. Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë elektrike(hidroenergji, energji e erës dhe biomasa solide) do të kanë kohëzgjatje prej 10 vjetësh, ndërsa Marrëveshja për Blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga panelet fotovoltaike do të ketë kohëzgjatjen 12 vjeçare, me çmime (tarifa nxitëse) të aplikueshme për pranuar në skemën mbështetëse.
4. Lidhja e Marrëveshjes për blerje të energjisë sipas kësaj rregulle është e garantuar për të gjitha njësit gjeneruese që janë të pranuar në skemën mbështetëse. Marrëveshja lidhet së paku (30) ditë para datës se fillimit të operimit të njësisë gjeneruese.

Neni 12

Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë elektrike

1. Furnizuesi Publik harton draft Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë elektrike për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë nga njësitë gjeneruese të pranuar në skemën mbështetëse.
2. Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë elektrike duhet të përfshijnë dispozita në bazë të së cilave njësia gjeneruese e pranuar në skemën mbështetëse zotohet se do të veprojë në përputhje me obligimet e dhëna përgjatë tërë kohëzgjatjes së marrëveshjes.
3. Furnizuesi Publik ne konsultim me ZRRE-në, përgatitë draft modelet e MBE-ve. Këto draft modele do të aprovohen nga ZRRE, pas konsultimit me palët e treta. ZRRE mund ta udhëzojë Furnizuesin Publik në çdo moment para nënshkrimit të MBE-së, që të bëjë ndryshime në këto draft modele ashtu siç e konsideron se është e nevojshme.
4. Brenda (15) ditëve pas pranimit të MBE-së, operatori i njësisë gjeneruese e nënshkruan dhe ia kthen një kopje Furnizuesit Publik. Shitja e energjisë elektrike te Furnizuesi Publik hyn në fuqi nga fillimi i muajit të (2) dytë pas datës në të cilën merret kopja e firmosur e Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike nga Furnizuesi Publik.
5. Brenda (15) ditësh nga pranimi i Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë Elektrike nga operatori i njësisë së gjenerimit, Furnizuesi Publik e informon OST/ OT-në dhe kur është e nevojshme, edhe OSSH-në, për datën në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike, për të aktivizuar procedurën e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të njehsimit (matjes).
6. Operatori i njësisë gjeneruese të pranuar në skemën mbështetëse i dërgon faturën mujore Furnizuesit Publik, brenda (24) njëzet e katër ditëve pas përfundimit të muajit, në bazë të informacionit të marrë nga Furnizuesi Publik. Faturat përgatiten në përfundim të muajit të tretë në vijim të muajit të cilit i referohen ato.
7. Shkëputja e MBE-së, nga ndonjëra nga palët kontraktuese sipas legjislacionit ne fuqi ka si rrjedhojë përjashtimin e njësisë gjeneruese nga skema mbështetëse dhe fshirjen e njësisë gjeneruese nga Regjistri i njësive të pranuar në skemën mbështetëse.

Neni 13

Integrimi i energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme

- 1 Operatori i Sistemit të Transmisionit i jep përparësi dispeçimit të energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, sipas nenit 12 të Ligjit të Energjisë Elektrike Nr. 03/L-201.
- 2 Njësitë gjeneruese të cilat prodhojnë energji elektrike nga BRE-të i nënshtrohen dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Kodit të Pajisjeve Elektrike, Kodit të Shpërndarjes, Rregullave të Tregut dhe çdo kodi ose rregulle tjetër të aplikueshme.
- 3 Njësitë gjeneruese të pranuar në skemën mbështetëse janë përgjegjëse për 25% të kostos së debalancit të shkaktuar.
- 4 Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i japin prioritet vlerësimit të aplikacionit për kyçje të dorëzuar nga njësitë gjeneruese që prodhojnë energji elektrike nga BRE-të, në mënyrë që të ulet sa më shumë që të jetë e mundur koha e nevojshme për përmbylljen e Marrëveshjes së Kyçje dhe për përfundimin e kyçje.

KREU III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Dispozitat kalimtare

1. Brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, aplikuesit të cilët posedojnë Njoftime mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar apo Autorizime finale, të cilat janë lëshuar sipas Rregullës për procedurën e autorizimit para hyrjes në fuqi të kësaj rregulle, duhet të plotësojnë kërkesën për pranim në skemën mbështetëse dhe do të pranohen në mënyrë automatike në skemën mbështetëse dhe do të trajtohen sipas kësaj rregulle duke marr parasysh caqet për BRE.
2. Brenda (90) nëntëdhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i dërgon Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimet për ndryshimet e nevojshme të Kodit të Rrjetit dhe kodeve të tjera teknike për zbatimin e dispozitave që përmban kjo Rregull.

Neni 15

Gjuha zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 16

Ndryshimi

1. ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 17
Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 18
Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Rregullën për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për pranim në Skemën Mbështetëse, të nxjerrë në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 dhe miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 29.12.2010.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bashkangjitur –Shtojca për aplikim në skemën mbështetëse.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar

Shtojca
Aplikacioni për Skemën Mbështetëse

| Detaje të aplikantit | | | | |
|---|---|------------------------------------|---|-----------------|
| Emri | | | | |
| Adresa | | | | |
| Personi (personat) kontaktues | | | Pozicioni | |
| Nr. Tel. | Nr. faks. | | Adresa e email-it | |
| Detaje të Njesisë Gjeneruese | | | | |
| Emri | | | Lokacioni | |
| Kapaciteti i instaluar (MW) Ne rast të prodhimit të kombinuar me lende djegëse konvencionale, paraqitet vetëm kapaciteti i BRE-se. | | | Prodhimi i vjetor i pritshëm (MWh) | |
| Burimet primare të Energjisë së Ripërtëritshme | | | | |
| Burimet | Teknologjia | Lloji | Sheno me X | Shënime shtesë. |
| Erë | Turbina Erë | | | |
| Diellor | Fotovoltaike | | | |
| Uji | Hidro | Me Rezervar | | |
| | | Mbi lumë (rrjedhëse) | | |
| Biomasa | Bimë energjetike | | | |
| | Nënproduktet pyjore dhe bujqësore dhe mbetjet | | | |
| | Biogaz | Gazi i deponive | | |
| | | Gazi i kanaleve të ujërave të zeza | | |
| | | Të tjera | | |
| | Energjia nga nënproduktet dhe mbetjet | Mbetjet komunale të ngurta | | |
| Nënproduktet industriale dhe mbetjet komerciale | | | | |
| Vendi dhe data | | | Nënshkrimi dhe vula e personit të autorizuar | |